



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

V E N D I M

Nr 69 dt.20.07.2001

**PER
MIRATIMIN E PROJEKTIT TE REHABILITIMIT TE DISA TROTUAREVE NE
QYTETIN E TIRANES DHE PROJEKTIT PER RESTAURIMIN ,
REHABILITIMIN DHE LYERJEN E DISA FASADAVE TE PALLATEVE NE
AKSET KRYESORE NE QYTETIN E TIRANES**

Në mbështetje të ligjit Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, Ligjit Nr.8654 dt.31.07.2000 relacioneve të paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, bazuar në relacionin e paraqitur me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

V E N D O S I

1. Miratimin e Projektit “Rehabilitimi i disa trotuarëve në qytetin e Tiranës” në shumën prej 18.000 mijë lekësh në favor të Ndërmarrjes Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit, në cilësinë e ndërmarrjes së specializuar, sipas listës dhe preventivit bashkëngjitur.
2. Miratimin e projektit “Projekti i restaurimit, rehabilitimit dhe lysterjeve të disa fasadave të pallateve në disa akse kryesore në shumën prej 25.000 mijë lekësh të Ndërmarrjes Komunale të Banesave, në cilësinë e ndërmarrjes së specializuara” sipas listës dhe preventivit bashkëngjitur
3. Fondi i mësipërm prej 43.000 mijë lekësh të përballohet nga zëri “Ndërtim i Urës mbi Lanë që lidh 2 segmentet e rrugës “Dëshmorët e 4 Shkurtit” në shumën prej 18.000 mijë lekësh dhe

zëri “Shtimtrotuarësh në Bul. Zogu i Parë” në shumën prej 25.000 mijë lekësh

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Ndërmarrja Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit dhe Ndërmarrja Nr.2 të Punëtorëve të Qytetit dhe Ndërmarrja Komunale Banesa
5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KRYETARI

Leonidha TOSKA

